



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti XIV
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin tetor 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA MINISTRE SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e katërbëdhjetë të trajtimit të ankesave, në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj.

Si cdo muaj në emër të transparencës ju raportojmë kërkesat e ardhura nga ju gjatë muajit tetor si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Këto kërkesa/ankesa i gjeni në vijim. Gjithashtu dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se më datë 17 tetor u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Ekonomik Kombëtar që pas kalimit të këtij organi në fushën e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Temë kryesore e kësaj mbledhje të Këshillit ka qenë "*Diskutimi i Buxhetit dhe Paketës Fiskale 2019*". Në kuadër të paketës së re fiskale dëshiroj gjithashtu të ndaj me ju arritjet tona sa i takon përfaqësimit të zërit tuaj, pasi paketa fiskale e vitit 2019 është fryt i një bashkëpunimi mes nesh dhe e propozimeve të sjella nga sipërmarrja në tryezat sektoriale të organizuara nga MSHMS. Ndaj po përmend vetëm tre prej tyre si:

- Ulja e normës së tatimit mbi dividendin nga 15 % në 8 %.
- Përfundimi nga TVSH i furnizimit të nënkontraktorëve për kontraktorët në industrinë fason, kërkesë sistematike e kësaj industrie në cdo takim të zhvilluar.
- Ndryshimi i skemës së taksës për ambalazhit plastik. Në paketë propozohet një nivel i ri i taksës që do të aplikohet mbi produktet e plastikës nga 100 lekë në 35 lekë/kg, pra sa 1/3 e nivelit ekzistues.

Ju lutem vijoni ta konsideroni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni çdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	02.10.2018	Subjekti depoziton ankesë lidhur me informalitetin ndaj shitjeve online nga rrjetet sociale.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.10.2018	Subjekti raporton bllokimin e llogarive bankare nga DRT Berat për mos shlyerje të detyrimeve tatimore.	Trajtuar me përgjigje sqaruese.
Nr.3	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	05.10.2018	Subjekti kërkon informacion nëse licenca e tij është pezulluar apo është shfuqizuar dhe shkaqet për të cilat është kryer ky veprim.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.4	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	05.10.2018	Subjekti raporton ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike.	Trajtuar me përgjigje mbi proceset e njoftimit nga ana e OSSHEE.
Nr.5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	07.10.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.6	Bashkia Tiranë	09.10.2018	Subjekti bën ankesë për mospërbushje të detyrimeve kontraktore të autoriteteve kontraktore.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	11.10.2018	Subjekti raporton gjobitje të padrejtë nga ana e Hetimit Tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.10.2018	Ankesë për mosmbyllje të NIPT nga ana e QKB.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	14.10.2018	Ankesë ndaj informalitetit (kontrabandë) në importimin e një produkti konkurrent.	Trajtuar me përgjigje nga Hetimi Tatimor.
Nr.10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	16.10.2018	Subjekti raporton ankesë për lajmërim jashtë afatit nga ana e QKB.	Trajtuar me përgjigje nga QKB.
Nr.11	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	17.10.2018	Ankuesi bën ankesë lidhur me vonesa në rinovimin vjetor të autorizimit për eksport.	Trajtuar me zgjidhje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.12	Bashkia Tiranë	17.10.2018	Subjekti bën kërkesë për likuidim detyrimesh nga UKT.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.13	APP	18.10.2018	Subjekti depoziton ankesë në lidhje me procedurat e prokurimit publik.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.14	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	20.10.2018	Subjekti bën kërkesë e për krijimin e një kontakti dhe asistencës procedurale për implementimin e projektit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.15	APP	21.10.2018	Subjekti depoziton ankesë në lidhje me kriteret e kualifikimit për procedurën e prokurimit publik.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.16	Bashkia Shkodër	22.10.2018	Subjekti raporton pengim ushtrimi të veprimtarisë në mënyrë të padrejtë nga Policia Bashkiake.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	23.10.2018	Subjekti kërkon rivlerësim doganor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.18	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	24.10.2018	Subjekti bën kërkesë për azhornim statusi në sistemin e tatimeve.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.19	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25.10.2018	Subjekti shprehet se ka aplikuar për t'u pajisur me license të kategorisë VII.3.B.1 "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove". Subjekti ka paraqitur dokumentacionet por nuk është dhënë ende.	Trajtuar me përgjigje nga OKB.
Nr.20	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	27.10.2018	Subjekti kërkon heqje akcize për gomat dhe bateritë.	Trajtuar me përgjigje .
Nr.21	ZRPP Lushnje	28.10.2018	Subjekti raporton vonesa në pajisjen me certifikatë pronësie.	Trajtuar me zgjidhje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.22	Bashkia Tiranë	28.10.2018	Subjekti raporton në lidhje me një gjobë të vendosur nga inspektorët e DPT-së në vitin 2012.	Në proces trajtimi me DPT.
Nr.23	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	29.10.2018	Subjekti raporton problematikë në lidhje me kalimin e padrejtë në statusin e biznesit të madh.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.24	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	29.10.2018	Subjekti dërgon propozim biznesi kërkon mbështetje nga ana e institucioneve shtetërore me qëllim zhvillimin e aktivitetit të turizmit përmes mjeteve të lundrimit ekologjike.	Në proces ndjekje nga AIDA.
Nr.25	Bashkia Tiranë	29.10.2018	Subjekti bën kërkesë për informacion në lidhje me procedurat e aplikimit me qëllim pajisjen me leje përdorimi të hapësirës.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	30.10.2018	Subjekti ankohet për pezullim të lejes mjedisore.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.27	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.10.2018	Subjekti raporton mbifaturim nga ana e OSSHEE	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.10.2018	Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjobitjen për punonjës të padeklaruar.	Trajtuar me përgjigje sqaruese.
Nr.29	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	31.10.2018	Subjekti raporton si të padrejtë gjobën e vendosur nga AKU.	Në proces verifikimi.
Nr.30	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	31.10.2018	Subjekti bën kërkesë për heqjen e detyrimeve për pagesat e principalit të kryera brenda afatit ligjor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.31	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	31.10.2018	Subjekti bën ankesë për referencat doganore.	Trajtuar me zgjidhje.

